



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Deçan, dhjetor 2021

R A P O R T I I P U N E S

2021

Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale gjatë periudhës njëvjeçare si asnjëherë ma parë është ballafaquar me gjatë gjithë kohës me një situatë të jashtëzakonshme e cila e ka karakterizuar periudhën e punës njëvjeçare te saj. Ndryshe, nga vitet e kaluara ne këtë prridhe janë shfaqur një varg situatash dhe vështirësish duke filluar nga ajo me pandeminë që është vazhdim i situatës së vitit të kaluar dhe e cila ishte specifik e sfidë e jashtëzakonshme në trajtimin e saj e pastaj këtë vit po ashtu e ka karakterizuar edhe me situatën e helmimit masiv të gati gjysmës së fshatrave të komunës tonë me uji të konsumit të përditshëm . Ballafaqimi me këtë gjendje ishte sfidë e madhe në të gjitha aspektet e gjendjes së krijuar si nga ana profesionale , organizative, hapësinore e te tjera. Përballja në të njëjtën kohë edhe me virusin Covid 19 , si sfida kryesore e gjithë botës, sidomos e këtyre dy viteve, ka kërkuar angazhim te jashtëzakonshëm të gjitha strukturave shëndetësore që nga niveli komunal e deri tek ai shtetëror. Sfidat dhe obligimet tjera të përballjes me sëmundjet tjera që janë përditshmëri në trajtimin ne nivel lokal për trajtimin e qytetarëve dhe mënyra e funksionimit dhe organizimit për ta përballua situatën në këto rrethana të veçanta po ashtu ka kërkuar funksionim te jashtëzakonshëm ne të gjitha segmentet e trajtimit shëndetësor .

| | |
|----|--|
| | OPSTINA DEÇAN MUNICIPALITY OF DEÇAN |
| | 1169 |
| 06 | 11.11.22 |

COVID 19

Gjendja e përgjithshme me Covid 19 në komunën e Deçanit gjatë vitit 2021

Pas një periudhe gati dy vjeçare po vazhdon gjendja e krijuar me pandeminë covid 19, e cila ka krijuar një situatë të jashtëzakonshme në të gjitha sferat e jetës në përgjithësi dhe veçanërisht në lëmin e shëndetësisë

Pothuajse pandemia ka ndryshuar në jetën shoqërore shumëçka duke e vënë gjithë botën para një sprove të madhe me të cilën rrallëherë është përballur. Ndikimi i pandemisë sidomos në ekonominë globale të të gjithë botës , në arsim , shëndetësi , jetën shoqërore e në të gjitha veprimtaritë tjera ka ndikuar brenda kësaj përudhë të ndodhin ndryshime dhe sfida të mëdha , të cilat kanë lënë dhe po vazhdojnë të lënë pasojë të jashtëzakonshme në shoqëri. Përpjekjet tona për v tu përballuar me këtë gjendje prej fillimit kanë të pandemisë e deri sot kanë qene sfida tepër e vështirë e cila na vënë para sprovave të shumta të ciklat kanë të bëjnë me menagjimin e gjendjes së krijuar për shëndetin e popullsisë .

Natyrisht barra e përballje me situatën në radhë të parë u ka rënë institucioneve shëndetësorë komunale n, të cilat në mënyrën e punës së tyre është dashtë të ndryshojnë shumëçka duke filluar nga çështja e përballimit me staf mjekësor e deri çështjet e krijimit të ambienteve të domosdoshme dhe adekuate për përballimin e situatës së krijuar. Në këto rrethanë të gjithë mekanizmat shëndetësorë janë angazhuar me një punë të shumëfishtë dhe me rrezik permanent të shëndetit të tyre sidomos nga mundësia e infektimit në çdo moment

4. Roli i komunës ne menagjimin e situatës

Shpallja e gjendjes emergjente dhe krijimi i shtabit emergjent

Reagimi i komunës së Deçanit ka qenë i menjëhershëm duke krijuar shtabin emergjent dhe po ashtu duke marr përsipër gjithë menagjimin e situatë së krijuar

5. Vizitat e mekanizmave shtetëror gjate kësaj kohe

- Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik i Kosovës
- Furnizimi me barna
- Analizat e ujit dhe Rekomandimet e ISHPK-se
- Ofrimi i ndihmës nga komunat e Kosovës

Mbi gjendjen e përgjithshme të helmimit të qytetareve të Deçanit

1. Puna stafit mjekësor të QKMF-së, për shqetësimet e tyre lidhur me numrin e shtuar të qytetareve që kanë kërkuar ndihmë në atë 24 orësh dhe komunikimit të menjëhershëm të stafit menagjuar respektivisht të drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe drejtorit të QKMF-së dhe diskutimit të situatës së krijuar menjëherë kemi komunikuar me Institutin e Shëndetit Publik Regjional me seli në Pejë respektivisht me Dr. Shqipe Krasniqin, duke ia shpjeguar gjendjen e krijuar në tërësi dhe po ashtu kemi kërkuar që Instituti të kyçet në situatën e krijuar. Në fillim, me që ishte dite e diel, ditë pushimi, ata kanë shfaqur brengosjen e tyre se në këto rrethana është e vështirë me reagu në mungesë të eksperteve përkatës, që në ato momente nuk i kanë disponua. Me insistimin tonë për domosdoshmërinë e reagimit të menjëhershëm pas rreth 2 orësh kohë, në QKMF kanë ardhur Dr. Shqipe Krasniqi dhe Dr. Bujar Pas diskutimit të situatës së krijuar dhe njoftimit për gjendjen ata janë kyç në procesin e mëtutjeshëm të analizës së situatës.

3. Organizimi dhe përballimi i situatës me helmim nga QKMF-ja

- Periudha sa ka zgjatur koha e helmimeve DSHMS-ja bashkë me drejtorinë e QKMF-së
- Raportimet ditore për gjendjen e krijuar

| | |
|----------------------------------|--------------------------------------|
| Me dt:10-11. 07.2021, trajtuar | 428 pacientë |
| Me dt:12.07. 2021, të trajtuar | 324 pacientë |
| Me dt:13.07. 2021, të trajtuar | 310 pacientë |
| Me dt:14.07. 2021, të trajtuar | 252 pacientë |
| Me dt:15.07. 2021, të trajtuar | 187 pacientë |
| Me dt:16.07. 2021, të trajtuar | 120 pacientë prej tyre 10 recidivist |
| Me dt:17.07. 2021, të trajtuar | 78 pacientë prej tyre 6 recidivist |
| Me dt:18.07. 2021, të trajtuar | 39 pacientë prej tyre 5 recidivist |
| Me dt:19.07. 2021,, të trajtuar | 59 pacientë prej tyre 4 recidivist |
| Me dt:20.07. 2021, të trajtuar | 50 pacientë prej tyre 9 recidivist |
| Me dt.: 21.07.2021 të trajtuar | 50 pacientë |
| Me dt.: 22. 07. 2021 të trajtuar | 59 pacientë prej tyre 19 recidivist |

15.07.2021

- Hyoscine butomibromide amp 300 copë
- Ranitidin amp 50mg 3000 copë
- B – complex amp 2000 copë
- metoklopramid amp 10 mg 3000 copë
- Gentamicin 40 mg amp 3000 copë
- Paracetamol tabl 500 mg 1800 copë
- NaCl 0.9% 100 ml 4000 copë
- Ceftriaxone 1 gr amp 2000 copë

7. D Donacionet e pranuar me rastin e gjendjes emergjente

Donacion nga : Agnesa Vokshi me 12.07.2021

- Sistema 85 copë
- Bebi Sistema 20 copë
- Analgin amp 20 copë
- Bedoxin amp 110 copë
- Vitamin C amp 160 copë
- Reglan amp 5 copë
- Ringer Sol 24 copë
- B – complex amp 25 copë
- NaCl 0.9% 500 ml 10 copë
- NaCl 0.9% 100 ml 10 copë
- Gentamicin amp 140 copë

Me datën 13.07.2021

- Sistema 100 copë
- Bebi Sistema 43 copë

Donacion nga Qerqiz Sylaj me 13.07.2021

- NaCl 0.9% 30 copë
- Gentamicin 40 copë
- Ranital 50 copë
- Sistem për infusion 30 copë

Donacion nga Mirlinda Tishukaj-Sadiku me 13.07.2021

- NaCl 0.9% 500 ml 70 copë

Donacion nga Kastriot Hulaj me 13.07.2021

- Ringer 500 ml 45 copë
- NaCl 0.9% 500 ml 30 copë
- NaCl 0.9% 100 ml 89 copë
- NaCl 0.9% 250 ml 10 copë
- Bedoxin amp 100 copë
- Ranital amp 95 copë
- Vitamin C amp 40 copë
- Gentamicin amp 50 copë
- Ketonal 100mg amp 20 copë

Donacion nga laborator BIO- HIT me 13.07.2021

- Ringer Sol 500 ml 11 copë
- NaCl 0.9% 500 ml 12 copë
- NaCl 0.9% 100 ml 80 copë
- Ketoprofen 100 mg amp 50 copë
- Bedoxin amp 45 copë
- Gentamicin amp 100 copë
- Diklofen 75 mg 20 copë
- Buscopan amp 20 copë
- Vitamin C amp 23 copë

Donacion nga Blend Sahiti me 14.07.2021

- Bedoxin tabl 30 copë
- Lactis B complex flacone 100 copë
- Equidral qese 70 copë
- Sistem I infuzionit 50 copë
- Analgin amp 30 copë
- Ranital amp 30 copë
- Reglan amp 100 copë
- B - complex amp 60 copë
- Buscopan amp 30 copë
- Bedoxin amp 30 copë
- Vitamin C amp 50 copë
- NaCl 0.9 % 250 ml 30 copë

- Dextrose 5% 100 ml 30 copë
- Dextrose 5 % 500 ml 30 copë
- Gentamicin amp 15 copë
- Lactis ferzým 62 copë
- Loperamid tabl 2mg 20 copë
- Gisflor caps 3 copë

Donacion nga Poliklinka Rezonanca Prishtine me 14.07.2021

- B complex amp 50 copë
- Rudavlleks 50 copë
- Ranital amp 40 copë
- Gentamicin amp 40 copë
- Traka te Glikemise 50 copë
- Gjilpera te glikemise 100 copë
- Leukoplast 1 pako
- Canilla 24 G 25 copë
- Ringer Sol 20 copë
- NaCl 0.9% 500 ml 30 copë
- Dorëza jo-sterile 100 copë
- Sistema per infusion 50 copë
- Maska 50 copë
- Alkool 70 % 1 L
- Alkool 250 ml 2 copë

Donacion nga Barnatorja Fati me 14.07.2021

- Ringer Sol 500 ml 10 copë
- NaCl 0.9% 100 ml 10 copë
- NaCl 0.9% 250 ml 10 copë
- Sistema per infusion 50 copë
- Bebi Sistema 45 copë

Donacionet

Shoqata Humanitare "Diaspora" Prishtine me 14.07.2021

- Uje – 2 paleta
- Leng Aroni 35 shishe 750 NH

Donacion nga FSK me 14.07.2021

- Maska mbrojtese 4000 copë
- Dorëza mbrojtese 3000 copë
- Kapela mbrojtese 1000 copë
- Mantela mbojtes 2000 copë

Donacion nga SH.H.B “ EDHE UNE DUA TE JETOJ “ me 14.07.2021

- Lemod Solu amp 40 mg 50 copë
- Bebi system 23 G 1000 copë
- Bedoxin amp 15 copë
- Buscopan amp 30 copë
- Reglan amp 30 copë
- Umepenta 40 mg amp 30 copë
- Linex caps 10 copë
- Flora Lactis 50 copë
- Buskolamin drg 50 copë
- Fural 200 mg tabl 30 copë

Donacion nga Avdullah Bytyqi me 14.07.2021

- Ujë 0.5 ml 10 pako

Donacion nga Dardan Bytyqi me 15.06.2021

- Maska 20 pako
- 30 dezinfektues

Donacion nga “ UBT “ me datën 15.07.2021

- Bedoxin amp 300 copë
- Vitamin C amp 300 copë
- Metoklopramid amp 130 copë
- Spasmex amp 300 copë
- Analgin amp 300 copë
- Citeral 100 mg / 5 ml 300 copë
- Termometer infrared 10 copë
- Tensionmeter Microlife 10 copë
- Pulsoksimeter 5 copë
- Stetoskop 10 copë
- B complex 300 amp

- Mantela nr. M dhe L 10 copë

Donacion nga Organizata “ QATAR CHARITY “ me 15.07. 2021

- NaCl 0.9% sol 2500 copë
- Ringer sol. 2500 copë
- Glukoze sol 2500 copë
- System infuzioni 2500 copë
- Canilla 2500 copë
- Shiringa 2500 copë
- Vitamin C amp 2500 copë
- Vitamin b am 2500 copë
- Reglan amp / ranitidine amp 2500 copë
- Lactis B flac. 1000 copë
- Reglan tabl (1/ 40 kutia) 1000 copë
- Equidral pulv 1000 copë

Trajtimi i pacienteve sipas ditëve

Me dt:10-11.07.2021 janë trajtuar 428 pacientë.

Me dt:12.07.2021 të trajtuar 324 pacientë

Me dt:13.07.2021 të trajtuar 310 pacientë

Me dt:14.07.2021 te trajtuar 252 pacientë

Me dt:15.07.2021 te trajtuar 187 pacientë

Me dt:16.07.2021 te trajtuar 120 pacientë prej tyre 10 pacientë janë recidiv

Me dt:17.07.2021 te trajtuar 78 pacientë prej tyre 6 recidiv

Me dt:18.07.2021 te trajtuar 39 paciente prej tyre 5 recidiv

Me dt:19.07.2021 te trajtuar 59 pacientë prej tyre 4 recidiv

Me dt:20.07.2021 te trajtuar 50 pacient prej tyre 9 recidiv

Nga dita e shtunë me 10 korrik 2021 në orët e mbrëmje ne QKMF e deri me 20.07.2021 në ora 07:00h, numri i të gjithë pacientëve të cilët janë identifikuar me simptoma si me lartë është **1847** pacientë.

Në 24 orët e fundit prej orës 07:00h të datës 19.07.2021 e deri në orën 07:00h te datës 20.07.2021 është **50 pacientë**.

Nëse bëjmë një analize te numrit te te trajtuarve kuptojmë që se krahasuar nga 24 orësh i fundit, ka pasur rritje te numrit te pacienteve (**saktësisht 9**), pacientë me pak se dita e mëparshme).

Në ditët e para ishte vështirësi të mëdha për shkak të listës esenciale, e cila ka qenë shumë e mangët, në mungesë të medikamenteve të nevojshme për ofrimin e ndihmës për pacientet me simptoma të lartshënuara.

Ditën e dyte, me arritjen e ndihmave nga donatorë ndryshëm, me të cilat u mundësua trajtimi përgjithshëm i pacienteve.

Kurse një dite me pas me date 13.07.2021, në orët e vona arritën edhe ndihmat e para nga Ministria e Shëndetësisë të cilat e kanë lehtësuar dukshëm situatën.

Me shumicën e medikamenteve jemi furnizuar për një kohë me të gjate, ndërsa për një numër të konsiderueshëm të medikamenteve tjera është gjeneruar listat çdo dite sipas nevojave.

Që nga data 13.07 prej orës 21:15 minuta me ardhjen e kontingjenti të parë nga M.SH (Barnatorja e SHSKUK), QKMF është furnizuar çdo dite. Po ashtu jemi furnizuar edhe nga donatorët tjerë e në vazhdimësi edhe nga Shtabi Emergjent Komunal, të cilët kanë mundësuar të mos kemi ngecje sa i përket medikamenteve dhe mjeteve për të vazhduar punën.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Adem Ukëhaxhaj” Deçan

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

1. Veprimtaria e QKMF-së përfshin ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.
2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Deçanit, t'u ofroj shërbime shëndetësore gjithëpërfshirës dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njehe rit pikë referuese për specialistët konsultat në nivelet të tjera të kujdesit shëndetësor.
3. Sipas strategjisë së KPSH dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000/2500 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.

Shërbimet shëndetësore që ofrohen nga niveli primarë shëndetësor.

- Shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshirë informimin , komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet;
- Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet e tjera parandaluese;
- Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike;
- Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent;
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike;
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshent dhe të rijnë;
- Shërbimet e shëndeti riprodhues;
- Shërbimet e shëndetit oral dhe parandalues;
- Shërbimet e shëndetit mendor;
- Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës, kujdesit paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në nevojat e popullatës dhe prioritetet e shëndetit publik;
- Shpërndarjen e barnave nga lista esenciale

Monitorimi i shërbimeve shëndetësore monitorohet nga stafi menaxhues si dhe strukturat relevante konfirm statusit të QKMF-së

- Drejtori
- Zv. Drejtori
- Shefi/ja e M.F
- Shefi/ja e Administratës
- Shefat e reparteve
- Kryeinfermieri
- Koordinatori për cilësi
- Koordinatori për ZHVP si dhe strukturat tjera të parapara me ligj dhe statusin e e QKIMF- së

Qendra kryesore e mjekësisë familjare së bashku me 3 qendra të mjekësisë familjare dhe 5 ambulanca të mjekësisë familjare ka gjithsejtë 121 punëtorë me kontrata të rregullta punë, si dhe 26 kontratë mbi vepër nga kryetari i komunës, 11 nga ministria e shëndetësie, gjithsejtë 158

mjekë specialist familjar 8, mjekë të përgjithshëm 8 ,mjekë në specializim 2 ,specialist peditër 1, mjekë specialist Dermatvenerolog 1,Specialist protetikës stomatologjike 1,Stomatolog 4.

Ndërsa staf i mesëm 54 infermier-re të përngjitëm, Infermiere peditrike 1,infermiere patronazhi 1, mami dhe infermiere akusherike 11, teknik radiolog 1,teknik laborant 7, teknik të farmacisë 2, teknik të dhëmbëve 2.

Departamenti i administratës 5 ,ngasësit – vozitësit 6 ,shtëpiak 1, pastrues 5.

Numri i stafit përmbushë kënaqshëm nevojat e qytetarëve të KK -Deçanit duke u bazuar në ligjin për shëndetësi ku një mjekë familjar duhet ti ketë 2000-2500 banor.

Ky vit po ashtu si vitin e kaluar ishte vit pandemik dhe ne u përballëm me sfida të reja me trajtimin e pacientëve me simptoma të Covid-19 si dhe **vaksinimin** e pjesës dërmuese të popullatës të komunës sonë.

Në fillim të muajit korrik u goditëm nga një sfidë e re , gjegjësisht me 10 korrik kur ishte vikend u njoftuam nga mjeku kujdestarë së është shfaqur një helmim në masë ,tek qytetarët të cilit nuk i dihej etiologjia .Menjëherë u mobilizua i gjithë stafi menaxhues dhe profesional.

Njëkohësisht është informuar IKSHPK dhe pesë dy orëve kanë arritur ekipi i IKSHPK në QKMF, është informuar Kryetari i Komunës z.Bashkim Ramosaj si dhe drejtori për shëndetësi Z. Musa Berisha ku është mbajtur takim i përbashkët dhe janë propozuar masat e duhura për përballimin e kësaj gjendje.

Nga Kryetari i komunës është shpall gjendje e jashtëzakonshëm në komunën e Deçanit.

Duke falenderuar gatishmërinë profesionale të stafit të QKMF-së dhe mbështetjen nga kryetari i komunës ne arritëm qe me sukses tija dalim përballë kësaj sfide.

U sensibilizuan të gjitha institucionet shtetërore dhe private ,individ të gatshëm për të na ndihmuar.Kishte donator të shumë të cilët na mbështeten me mjete dhe iliqe të ndryshme për përballimin e kësaj epidemie hidrike,(helmim me uji të pishem) e cila u diagnostikua dhe u trajtua me Dg: Entercolitisolitis acuta.

Objektet ekzistuese janë në gjendje të mire qe të ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët e komunës sonë , Këtë vit kalendarik u realizuan edhe këto projekte :

- ✓ Urgjenca
- ✓ Renovimi i pritorës në M.F
- ✓ Renovimi i këshillimores për diabet dhe hipertension,
- ✓ Renovimi i zyrëve në administrate
- ✓ Renovimi i nyjeve sanitare,
- ✓ Rregullimi i ambientit të jashtëm në QKMF,
- ✓ Ndërtimi i garazheve QKMF-së
- ✓ Renovimi i nxemjes qendrore në QKMF
- ✓ QMF Strelle rrëni i objektit ekzistues dhe ndertimi i objektit të ri,
- ✓ Inagurimi i objektit të ri AMF-së në Gramaçel.
- ✓ Rregullimi i pritorës në QMF Irzniq
- ✓ Rregullimi i pritorës në QMF Isniq

Sigurimi i pajisjeve mjekësore:

Me përpjekje të vazhdueshme të stafit menaxhues nga buxheti dhe donacionet.

Këtë vit arritëm të sigurojmë:

- ✓ Sigurimi i një Autoambulance të re
- ✓ Tri kërriga stomatologjike të reja ku janë funksionalizuar tri QMF-të me pajisje
- ✓ Tri laboratorëve hematologjik & biokimik nëpër QMF
- ✓ Aparati digjital i rëntgenit.

Furnizimi me iliqe dhe material shpenzues:

Në bazë të kërkesës vjetore nga njësia e barnatores jemi furnizuar me barna nga lista esenciale 49.6 %.

Mos furnizimi i rregullt nga M.SH. me listën e barnave esenciale, u obliguam të bëjmë zgjidhje alternative .

Nëpërmes zyrës së prokurimit sipas kontratës jemi furnizuar me reagenca për laborator material shpenzues për urgjencë ,material shpenzues për stomatologji dhe reparte të tjera.

Është bërë furnizimi i rregullt me material higjeno-sanitar,si dhe regjistrimi dhe servisimi i rregullt i automjeteve.

Po ashtu stafi është i kompletuar sipas nevojave të parapara me ligj në kujdesin parësorë shëndetësor.


Këtë vit është realizuar plani i paraparë për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve shëndetësor.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021

| KUVENDI KOMUNAL DEÇAN | | | | | | | | | | | | | | |
|-----------------------|--|------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|---------------------|
| SHPENZIMET | | | | | | | | | | | | | | |
| Instituti | QKMF- De | 2021 | | | | | | | | | | | | kodi 631-73900 |
| Nr/se | Pershkrim | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Totali |
| A | paga e regj | 68,715.41 | 70191.7 | 67301.46 | 67341.34 | 69016.97 | 68952 | 68133.16 | 68507.48 | 71482.55 | 61671.09 | 67754.52 | 68494.57 | 817,562.25 |
| 1 | kujdestarit | 5,138.30 | 5,792.72 | 4,426.68 | 4,418.08 | 5,721.59 | 12,323.87 | 6,504.12 | 7,800.66 | 6,194.92 | 5,356.47 | 4,146.20 | 5,830.02 | 73,653.63 |
| | pagesa e s | 20,737.50 | 21105 | 20737.5 | 17,325.00 | 17,325.00 | 0 | 0 | 7,407.86 | 7,407.86 | 7,239.38 | 7,491.38 | 7,014.65 | 133,791.13 |
| | Me vendime gjyqsore | 121423.68 | | | 2,803.32 | | | | | | 17,572.40 | | | 141,799.30 |
| B | Total të ar | 94,591.21 | 218,513.00 | 92,465.64 | 91,887.74 | 92,063.56 | 81,275.87 | 74,637.28 | 83,716.00 | 85,085.33 | 91,839.34 | 79,392.10 | 81,339.24 | 1,166,806.31 |
| 1 | Të mirat dhe Shërbimet | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 1.1 | Shpenzimet e udhëtimit | | | | | | | | | | | | | 0 |
| | Shpenzimet e udhëtimit | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 0 | Tot Shpenzimet e udhëtimit | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 2.1 | Komunaliet | | | | | | 2617.5 | | | | | | | 2,617.50 |
| 2.2 | Telefoni | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 2.3 | Telefoni fikse | | 180.78 | 81.21 | | | 335.44 | 83.78 | | 223.52 | 141.78 | | | 1,046.51 |
| 2.4 | Uji | | 236.43 | 149.77 | | | 650.92 | | | 689.47 | 177.03 | 103.37 | | 2,006.99 |
| 2.5 | Rryma elektrike | | 2036.88 | 1,638.41 | | | 3,790.49 | 842.34 | | 1,859.82 | 1071.97 | 1868.77 | 159.77 | 13,268.45 |
| 2.5 | Mbeturinat (Plehu) | | | | | | | 181.5 | | 181.5 | 363 | | | 726 |
| 2.6 | Permbanus privat | | | | | | | | | | | 11394.55 | | 11,394.55 |
| 3 | Totali i Kod | 0 | 2454.09 | 1869.39 | 0 | 0 | 7394.35 | 1107.62 | 0 | 2654.31 | 1753.78 | 13356.69 | 159.77 | 31050 |
| 4 | Komunikimet-intemeti | | | | | | | | | | | | | 0 |
| | Shpenzime tjera tle mc | | 1176.74 | 566.47 | | | 1,833.77 | 596.27 | | 1312.42 | 708.19 | | | 6,193.86 |
| | Totali i kç | 0 | 1176.74 | 566.47 | 0 | 0 | 1833.77 | 596.27 | 0 | 1312.42 | 708.19 | | | 6,193.86 |
| 4.1 | SHERBIMET | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 4.2 | Mirëmbajtja e automjeteve | | | 2,468.38 | | | 2,634.20 | 550 | | 3580 | 2060 | 150 | | 11,442.58 |
| 4.3 | Mirëmbajtja e pajisjeve | | | | | | 27.8 | | | | | | | 27.8 |
| 4.4 | Mirëmbajtja e rjetit | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 4.5 | mimmbajtje rutinore | | | | | 7455.8 | | | | | | | | 7,455.80 |
| 4.6 | Mirëmbajtja e ndërtesave (objekteve) | | | | | | 2494.3 | 1118.6 | | | | | | 3,612.90 |
| 4.6 | Sherbime kontraktuse | 16292.5 | 8934.05 | 362.8 | | | 14314.99 | 9171.95 | 4466.71 | 10238.45 | 13354.55 | 8713.37 | 7845.3 | 93,694.67 |
| 4.7 | Sherbime | 1800 | | 1656.17 | | | | | | | 11871.11 | | | 15,226.28 |
| 4.8 | Shërbimet e per R T G | | 30 | 60 | | | 142 | 270 | | | 171 | | | 673 |
| | Shërbime tjera- Sigurim dhe regji autove | | | | | | 715.55 | | | | 231.89 | 1,829.08 | | 2,776.52 |
| 5 | Total Sherf | 1800 | 16322.5 | 11462.43 | 1917.97 | 7455.8 | 20328.84 | 11110.55 | 4466.71 | 13818.45 | 27688.55 | 10692.45 | 7845.3 | 134909.55 |
| 5.1 | Pajisjet/Qirraja/Blerja | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 5.2 | Pajisjet | | | | | | | 1300 | | | | | | 1,300.00 |
| 5.3 | Mobiljet | | | | | 13999 | | | | | | | | 13,999.00 |
| | Pajisje speciale mjeksore | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 6 | Totali: | 0 | 0 | 0 | 13999 | 0 | 1300 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 15299 |
| 6.1 | Furnizimet | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 6.2 | Material për zyre | | | | | | | | | 1,605.00 | | | | 1,605.00 |
| 6.3 | karburant per generator | | | 152.51 | | | | | | | 488.68 | | | 641.19 |
| 6.3 | Dizell&Benzin për automjete | | | 4099.42 | | | 1,312.70 | 2,613.91 | 3,207.50 | | 2,898.20 | | | 14,131.73 |
| 6.4 | Material mjekësor (barna, reagjens) | | 1,202.00 | | | | 7385.4 | | | 10,881.00 | | 1,500.00 | 1996 | 22,964.40 |
| 6.5 | Material per mirmbajtje dhe higjen | | | | | | 2314 | | | | | 1,999.00 | | 4,313.00 |
| 6.6 | Furnizime ushqim dhe | | 140 | 105 | | | 499.77 | 111.8 | | 210 | | | | 1,066.57 |
| | Fur për dimërim (naft, dru) | | | | | | 18793.15 | | | | 2826 | | 30000 | 51,619.15 |
| 7 | Totali i Furnizimeve | 140 | 5558.93 | 0 | 0 | 0 | 30306.02 | 2725.71 | 3207.5 | 12696 | 6212.88 | 3499 | 31996 | 96341.04 |
| | Dreka zyrtare | | | | | | | | | | | | | 0 |
| | Cekeni ju lutem | | 1000 | | | | | | | | | | | 1,000.00 |
| | Totali Të Tjera | - | 1,000.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,000.00 |
| C | Tot i mall s | 1800 | 18639.24 | 17587.83 | 1917.97 | 21454.8 | 52467.63 | 15732.53 | 7674.21 | 27826.87 | 34609.62 | 14191.45 | 39841.3 | 253743.45 |
| 1 | Kapitale- | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 2 | Mirmbajtje investive | | | | | | | | | | | 6610.6 | | 6,610.60 |
| 3 | Ambulanta Gramaogel | | | | | | | | | | | 9962.05 | | 9,962.05 |
| 4 | Me permbarus vend gjyqsor | | | | | | | | | | | 9303.75 | | 9,303.75 |
| 5 | Garazha | | | | | | | | | | | 34972.98 | 26461.8 | 61,434.78 |
| | Totali i Kapitaleve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 60849.38 | 26461.8 | 87311.18 |
| | Totali i Tç | 96,391.21 | 72,017.58 | 111,922.86 | 93,805.71 | 113,518.36 | 141,137.85 | 91,477.43 | 91,390.21 | 115,866.51 | 128,202.74 | 167,789.62 | 147,802.11 | 1,538,910.84 |


Buxheti i shpenzuar për vitin 2021

| Paga | Malra dhe shërbime | Shpenzime komunale | Shpenzime Kapitale |
|------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| 1166806.31 | 253,746.45 | 31050.00 | 87311.18 |



| Mjetet e shpenzuara në kategorinë e pagave për vitin 2021 | | |
|---|--------------------------------------|----------------------------|
| | | |
| Paga e rregullt | Kujdestaritë dhe puna e natës | Shtesa për covid 19 |
| 817562.25 | 73,656.63 | 133791.13 |

Totali i buxhetit 1,166,806.31



BUXHETI I PLANIFIKUAR PER PAGA ISHTE


980,276.39

TRANSFERE NGA MINISTERIA E FINANCAFE -SHTES NE KATEGORIN E PGAVE **186,529.92**

Departamenti i Shëndetësisë

| Te hyrat për vitin 2021 | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|-------------------------------------|------------|-----------------|--------|--------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|----------|
| Institucioni Shëndetësor: QKMF "Adem Ukehaxhaj" Komuna: DEÇAN Data e raportimit: 30.12.2021 | | | | | | | | | | | | | | | |
| Sr. no | Përshkrimi i të mbledhurave | Aktualisht | Parashikimi për | | | | | | | | | | | | Totali |
| | | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nandor | Dhjetor | |
| | Pagesat për Participime të ndryshme | | | | | | | | | | | | | | |
| | a.TEHYRAT NGA PARTICIPIMI | 562.00 | 801.00 | | 293.00 | 304.00 | 177.00 | 365.00 | 287.80 | 834.00 | 208.00 | 226.00 | 179.00 | 454.00 | 4 690.80 |

| Përshkrimi i të mbledhurave | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nandor | Dhjetor | Totali | |
|-----------------------------|--------|--------|------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|--------|---------|
| Te hyrat e planifikuara | 2000 | 2000 | | 2000 | 1500 | 1500 | 1500 | 2000 | 2500 | 1000 | 1000 | 1500 | 1500 | 20000 |
| te hyrat e realizuara | 562.00 | 801.00 | | 293.00 | 304.00 | 177.00 | 365.00 | 287.80 | 834.00 | 208.00 | 226.00 | 179.00 | 454 | 4690.8 |
| Diferenc | 1438 | 1199 | | 1707 | 1196 | 1323 | 1135 | 1712.2 | 1666 | 792 | 774 | 1321 | 1046 | 15309.2 |
| shuma e realizuare ne % | 28.10% | 40.05% | | 14.65% | 20.27% | 11.80% | 24.33% | 14.39% | 33.36% | 20.80% | 22.60% | 11.93% | 30.27% | 23.45% |



Numri i Vizitave dhe shërbimëve shëndetësore për vitin 2021

| Totali i shërbimeve shëndetësore në vitin 2021 | | | |
|--|----------------------|---------------|----------------|
| Nr.r | Vizita Mjekësore | 84288 | 12.90% |
| 1 | Përshkrim i terapisë | 70174 | 10.74% |
| 2 | Udhëzime | 9710 | 1.49% |
| 3 | Ultrazë | 1589 | 0.24% |
| 4 | Shërbime tjera stom | 6573 | 1.01% |
| 5 | Ineksione | 67472 | 10.33% |
| 6 | Infuzione | 24716 | 3.78% |
| 7 | Inhalime | 569 | 0.09% |
| 8 | Triazhime | 27650 | 4.23% |
| 9 | Pastrim, qepje plage | 12390 | 1.90% |
| 10 | Heqje te rriqname | 143 | 0.02% |
| 11 | EKG | 4627 | 0.71% |
| 12 | Vizita Shtëpiake | 1080 | 0.17% |
| 13 | Vizita ne Covid-19 | 4420 | 0.68% |
| 14 | Teste Rapid Cov | 1512 | 0.23% |
| 15 | Vaksina | 37141 | 5.68% |
| 16 | Laboratori | 266748 | 40.82% |
| 17 | RÖ-Kabineti | 9733 | 1.49% |
| 18 | Barnatorja | 22900 | 3.50% |
| | | | |
| Totali | | 653435 | 100.00% |
| | Vizita mjekësore | 84288 | 89.67% |
| | Udhëzimet | 9710 | 10.33% |
| | Totali | 93998 | 100.00% |

Raporti i Komitetit për Cilësi si dhe raporti i vaksinimit kundër Covid – 19

Viti 2021 ka qenë një vit sfidave për personelin shëndetësor e sidomos për menagjimentin e institucioneve shëndetësore. E gjithë puna e Komitetit të Cilësisë e sidomos e Koordinatorit të Cilësisë është fokusuar në menagjimin dhe mbarëvajtjen e procesit të vaksinimit, gjë që e ka bërë me të vështirë fokusimin në auditet e brendshme në institucionin tonë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Pas formimit të Komitetit të Cilësisë është bërë një revidim i reparteve brenda QKMF-së. Është filluar me repartin e emergjencës. Është bërë kontrollimi i stokut të barnave brenda repartit dhe regjistrimi i tyre, kontrollë e qantave të urgjencës, asgjësimi i barnave me afat të skaduar, kompletimi i setit higjienik, aparaturës së nevojshme, kontrolle e protokolleve dhe plotësimi i tyre në mënyrën e duhur gjë që vazhdon të bëhet. E njëjta kontrolle ka vazhduar në repartet tjera ku janë evidentuar mjetet e nevojshme të punës për të gjithë mjekët, prania e letrës higjienike, shamponit dhe ujit të nxehtë, që janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe evitimit të infeksioneve. Gjithashtu është bërë kontrolle në QMF ku janë evidentuar parregullsi nga ana higjienike, mungesë e mjeteve të punës, të cilat janë raportuar dhe përmirësuar në afat të shkurtër kohor.

Raporti i vaksinimit kundër SARS COV në Komunën e Deçanit

Dozat e para të vaksinës AstraZeneca në komunën tonë janë pranuar me datën 12.04.2021 kur edhe ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve të IKSHPK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Duke pasqyruar faktin që personeli shëndetësor kanë qenë faktori bazë në luftimin e pandemisë njëkohësisht edhe një kategori e atakuar ndaj infeksionit, ka qenë prioritet në procesin e vaksinimit. Pastaj është vazhduar me kategorinë mbi moshën 85 vjeç, personat me sëmundje kronike, ata të cilët janë në hemodializë, të sëmuret me nevojë të veçanta dhe tash vazhdohet me moshën mbi 65 vjeç, gjithmonë sipas rekomandimeve dhe protokolleve të parapara. Gjatë çdo muaji në vazhdim MSH ka miratuar rekomandimet për aplikim të vaksinës nga moshë 18 vjeçare, pastaj 16 vjeçare vetëm me vaksinën Pfizer BioNtech, grave shtatzëna vetëm me vaksinën Pfizer BioNtech dhe së fundmi fëmijëve të moshës 12-15 vjeç vetëm me Pfizer BioNtech.

Procesi i vaksinimit është realizuar në bazë të planit të veprimit të hartuar paraprakisht. Ky proces është zhvilluar nga ekipet e vaksinimit të trajnuara për aplikim të vaksinës të ndara në dy ndërrime gjatë shtatë ditëve të javës. Ekipet janë të përbëra nga mjeku përgjegjës dhe dy infermiere si dhe ekipi mbështetës që sigurojnë një mbarëvajtje të mirë të procesit. Nga 15 Qershori e tutje procesi i vaksinimit është realizuar me 6 ekipe mjekësore të ndihmuara nga specialistët e

angazhuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Në komunën tone janë angazhuar 8 specializant: 15 qershor-15 gusht 4 specializant dhe 15 gusht-15 tetor 4 specializant. Procesi është ndarë në dy ndërrime me nga 3 ekipe; ndërrimi paradite nga ora 07:00- 13:30 dhe ndërrimi pasdite nga 13:30-20:00. Po ashtu nga ana e MSH-së, janë angazhuar edhe 9 infermier për të ndihmuar në procesin e vaksinimit si dhe vullnetarët nga Kryqi i Kuq.

